ALBAN TUFA

KU LULET ÇELIN DHE NUK VYSHKEN

ROMAN

BOTIMET TOENA

Alban Tufa

Ku lulet çelin dhe nuk vyshken

roman

BOTIMET TOENA
Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Mirgjina Lekaj
Përkujdesja grafike: Rogen Alushani
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928961075

©AUTORI & BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. “M. Gjollesha”, nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
https://toena.al

Për time shoqe, Besën.

Për motrat dhe vëllezërit e mi:
Dinin, Lolën, Metin dhe Anën.

NË VEND TË NJË PROLOGU

Nuk e di se nga çfarë shtysash më jepej të qaja. Të qaja aq shumë, me tërë fuqinë e trupit, atij trupi të pasprovuar ende në një kuptim domethënës. Fillimisht m'u dha një si gjendje melankolie, si një përmallim ngase po braktisja një vend në të cilin kisha kaluar një periudhë të gjatë të jetës sime të shkurtër, periudhë e cila, duhet theksuar, ishte shumë e lumtur. E mandej m'u bë si një domosdo, si një rrugë që duhej përshkuar me doemos. Sikur fryma po më zihej, në fakt, më ishte zënë, dhe duar të stërmëdha dhe të stërfuqishme më shtynin për të dalë. Mu sikur dikush nga prapaskena, dhe ky dikush të kishte shtatë palë duar, më shtynte për të dalë pa dëshirën time në skenë. Në atë skenën e dhjetëra projektorëve dhe një mijë spektatorëve që prisnin me padurim daljen time. Por unë, nuk e dija se çfarë teksti duhej të luaja, çfarë roli, çfarë pamje duhej të merrja në fytyrë, e as çfarë pozicioni duhej të mbaja, gjëra, të cilat, edhe nëse do t'i dija, nuk kishin tash kurrfarë kuptimi, ngase unë nuk e kisha pikën e përvojës.

Ju e dini se cili është rezultati, ose shpëtimi në kësi rastesh. Pika fundore, pika shkarkuese është e qara. Po po, zgjidhja, ose zgjedhja e detyruar është të qash. Të qash aq fort, tek i jepesh asaj me tërësej derisa të tranden mushkëritë, të shpohen veshët e spektatorëve, dhe britma jote të kapërcejë përtej godinës së teatrit tënd. Dhe do

të thoni ju se ku është suksesi këtu? Nuk bëhet fjalë për kurrfarë suksesi, por dështimi. Ja kështu nis jeta ime, me një dështim të cilin të gjithë e kanë duartrokitur.

Disa çaste para të qarës, në atë terrinë të plotë në prapaskenë, nën forcën shtytëse të shtatë palë duarve, dhe nën forcën tërheqëse të nja shtatë palëve të tjerave, që kishin ardhur si ndihmë e shpejtë nga jashtë, u rrotullova me kokë poshtë. M'u duk çmenduri. Çmenduri e atij regjisori që po më nxirrte në skenë në këtë mënyrë të çuditshme, me kokë poshtë. Ja pra ç'na qenka, një shfaqje e pa parë me herët, ose së paku një shfaqje që luhet rrallë. Tash ky na qenka fati im, të futem për së pari herë në skenë me kokën poshtë. Dhe kështu fillova të epesha nga pas perdes, të shihja siluetat e disa spektatorëve.

M'u dukën shumë pak në krahasim me çka imagjinoja. Spektatori i parë në këtë skenë madhështore që më zunë sytë, ishte xhaxhesha ime e madhe. Ja pra, shtatë palët e duarve të saj na paskan ardhur në ndihmë për të më tërhequr mu në mes të skenës. Ndërsa spektatori i dytë na qenka edhe kjo xhaxheshë, por kësaj here e vogla fare. Një vajzuke e sapomartuar, që duke e krahasuar me spektatorët e tjerë që më zunë sytë edhe më vonë, sytë e saj mbetën më të bukurit.

E qara që më ishte mbledhë në grykë, me t'u përballur me të parin projektor, shpërtheu. Britma ime ishte madhështore krahasuar me trupin tim të vockël. Aq madhështore ishte kjo britmë sa shpërndahej me një jehonë të padëgjuar më parë në Grykën e Shterpës. Në atë valë britme, në atë zjarrmi dhe dëshpërim të madh, që më kishte kapluar, e dëgjova xhaxheshën e madhe teksa më ngrinte në qiell si një trofe, tek thoshte:

- Është djalë! - Është djalë!

- Mbaja kokën, vëri dorën nën kokë, - tha një grua mbi të gjashtë dhjetat, e cila më vonë m'u prezantua si xhaxhesha e babait.

- Gërshërët, Lizë! - urdhëroi xhaxhesha e mesme, xhaxheshën vajzuke, - I duhet prerë kërthiza.

- Shihe, Basime! Është djalë. Djali yt i si dash! - i tha xhaxhesha e madhe një gruaje që rrinte shtrirë në një krevat *doppio*.

Mesa munda ta shoh m'u duk e dërrmuar. Trupi i saj ishte lëshuar me tërësej në gravitetin e krevatit dhe për një çast m'u bë sikur po luftonte mes jetë a vdekjes. Ishte e mbështjellë krejt me të bardha. E kishin mbuluar me do çarçafë, sikur shtresa njëpëllmbëshe e dëborës që binte jashtë, të kishte rënë edhe mbi krevatin e asaj dhome. Fytyra e saj ishte ngjyrë mavi. Si duket këtë ngjyrë e kishte marrë nga stërmundimet e lindjes. Sytë e saj ngjyrë kafe, dukej sikur protestonin vakët në qendër të asaj fytyre mavi. Them vakët ngaqë ata ishin gjysmë të hapur. Flokët e saj kaçurrela derdheshin çrregullt mbi jastëkun e saj të bardhë.

Nuk e di se për çfarë dreq arsyeje, e gjitha më ngjate si një formë kundërshtie, sikur e gjitha kjo skenë ndërtohej nga kundërvëniet, përballjet. Unë me britma dhe të qara, ajo krejt e heshtur në atë shtrat. Flokët e sime ëme tis të zeza, ndërsa çarçafët në të cilët ato derdheshin, krejt të bardha. Fytyra e saj mavi, ndërsa sytë e saj kafe. Xhaxhesha ime e madhe, krejt krenare, ndërsa xhaxhesha ime e vogël, krejt e butë, e tërhequr. Temperatura e nxehtë e dhomës me sobën që bubullonte prej drurëve të ahut, teksa dëbora e parë e vitit, kishte shtruar shtatëdhjetë palët e saj të çarçafëve në të gjithë Grykën e Shterpës.

Teksa e këqyrja me vëmendje dhe habi atë fytyrë mavi, m'u bë sikur diç donte të më thoshte. Sikur po kurdiste

një kod të fshehtë. U mundova ta lexoj, të shkoj përtej asaj çka mund të kuptonte kushdo në atë dhomë, por më kot. Gjithë sa arrita të rrok, nuk qe veçse një buzëqeshje e ëmbël, sigurisht e nxjerrë me shumë mund, ama m'u bë krejt e çiltër dhe e pafundme. Kur sapo nisa ta shijoja në plotësinë e vet atë buzëqeshje të paanë, dhimbja që ma dha gërshëra ngjitur me barkun, qe therëse deri në tru. Ktheva kokën dhe ia dhashë një britme edhe më të madhe, aq sa mend po e refuzoja jetën që sapo më ishte dhënë. Në këtë gjendje dhimbje dhe kllapie gjërat po më dukeshin ende të paqarta. Nuk isha mësuar akoma me këto lloj spektatorësh. Aq mendova, sa t'ia gjesh anën këtij publiku dhe do t'i kesh më të lehta këto situata. Ja, në këtë pështjellim e sipër mund ta rrokja zërin xhaxheshës së babait tek thoshte:

- Basimen, Basimen këqyreni! - Nuk bën të flejë që tani!

- Ç'është gjithë ai gjak?

- Placenta!

- Jo.

- Nuk para ndodh kështu.

- Kujdes, kujdes!

Ndërkohë nga qielli nuk binin flashka dëbore, por zogj të bardhur. Nuk ishte parë e dëgjuar kurrë në Grykën e Shterpës një dëborë e tillë e parë vjeshte.

Fytyra e të parit spektator mashkull, që pashë në këtë jetë, qe një fytyrë e rruar taze, por me një palë mustaqe pis të zeza, të cilat zgjateshin deri në mesin e faqeve.

E pashë tek afrohej krejt qetë, ose para se ta shihja, i ndjeva duhmën, atë farë prezence e cila vjen pak para se të arrijnë burrat e rëndësishëm. U afrua fillimisht hija e tij, te ma zuri dritën që lëshonte llapma e verdhë në tavan, e mandej u dha fytyra bashkë me mustaqet. Më shumë sa

fytyra e tij, duhma a prezenca, më rrëqethi timbri i trashë i zërit, sikur të qe në përplasje metalesh të forta, teksa tha:

- Mirë se erdhe këtu biri im! InshAllah ta kesh jetën e gjatë!

Nuk dija çka t'i thosha, por sigurisht që ia pranova urimin. Dora e tij e madhe që futej në kokën time, më shkëputi nga përpjeka për t'i dhënë përgjigje. E mandej, me dorën tjetër, që e zhyti nën shpinë, më çoi hopa dhe duke përshkuar dhomën cep më cep më shpuri pranë dritares dhe sikur të donte të kalonte nga dritarja në oborr, tha:

- A e sheh në çka moti ke lindur biri im! Vizë Furtunë. Do me thanë që do të jesh djalë abrash.

As këtu nuk dija ç't'i thosha. Unë abrash? Po çka donte të thoshte me këtë? Ç'na qenka një abrash? I mirë apo i keq? I shkathët apo i ngathët? Unë i shkathët? Unë që nuk munda të dilja i vetëm në skenë? Unë që m'u deshën katërmbëdhjetë palë duar për të më shtyrë e tërhequr në këtë skenë? I mbarë, paj, kurrsesi! Unë që desha të hyj në ketë skenë më këmbë dhe këta më kthyen e më futën përmbys? Një Zot e ti se çka duan të thonë këta spektatorët e këtushëm. Duhet të mësohesh me gjërat e reja, i thashë vetes. Por sidomos duhet të krijosh miqësi me fjalët. Ato e kontrollojnë këtë skenë gjigante. Ato i prishin dhe i ndreqin gjërat.

Mendova që do bënte mirë të më fuste te krevati im i vogël sërish dhe të mësohesha pak nga pak me pamjet, dhe të kuptoja vetë si motin ashtu edhe abrashin. Dhe për çudi, ose jo për çudi, sepse im atë është aq i zgjuar sa të të kuptojë vetëm prej çehres, pa i thënë ende asnjë fjalë, më la sërish në vendin tim. Por si për të mos më lënë rehat, ashtu siç ka bërë gjithmonë, ma futi një mizë në kësulë, duke thënë:

- Nuk do të merremi me ty për momentin, kemi një hall më të madh.

Çfarë halli na qenka ky, më i madh se sa unë!? Sigurisht ata të gjithë ishin më të mëdhenj se unë, por halli? A nuk isha unë që po vija në skenë, dhe ata duhej të më këqyrnin vetëm mua. A nuk ishin ndezur të gjithë projektorët vetëm për mua? A nuk ishin mbledhur të gjitha xhaxheshat për të më sjellë mua në skenë dhe mandej për të këqyrur shfaqjen time?

Ja, në këto mendime e sipër, më kaploi një gjumë i thellë, aq sa, përnjëmend m'u bë se isha kthyer edhe njëherë në prapaskenë, në atë vend të qetë e shëlbues, pa drita e projektorë, pa spektatorët gjykues dhe paragjykues, dhe më e mira, pa fytyra e të gjitha xhaxheshave të fisit.

Me sa duket, e gjitha kjo nuk zgjati shumë. Fillimisht m'u bë se po më zgjonin do të qara njerëzish, sikur në skenën ku unë kisha qenë, më shumë se sa unë, po britnin spektatorët. Kur dhashë të hap sytë, dhe të shqyrtoja situatën, vura re që më shumë se çdo britmë, po më çmendte britma ime, e cila më futej në veshë sa nga jashtë, aq edhe nga brenda.

SËRISH RROBAT E BARDHA?

Nuk kisha parë kurrë në jetën time aq shumë fëmijë njëherësh. Motrat e mia më patën marrë përdore deri tek oborri i shkollës, e pasi u përshëndetën me disa nga shoqet e veta, duke më prezantuar me to si Bekimi, vëllai i tyre i vetëm, më shpunë mandej te një grua e veshur me një mantel të bardhë, si të qe infermiere. Ndjesia që më dha kur e pashë për së pari herë, më rrëqethi mishtë.

Përherë këto veshje të bardha më kanë dhënë njëfarë velenie, sikur gjaku më zbret me atë turr që merr uji në tubat e trasha të HEC-eve dhe shtyn me përdhunë turbinat, drejt e në fund të këmbëve.

Ja sërish e bardha, vize thashë me vete. Bash si infermierja e Shterpës, ku sa e sa herë, krejt në të beftë, shfaqej në shqeme të derës sonë, me kutinë e saj të bardhur, më atë plusin e kuq mu në pamjen ballore. Dhe ashtu në beftin e saj, më zinte gafil herë në oborr dhe herë të tjera në odë, gjithë me atë buzëqeshjen e sajuar mu fill para portës sonë. E mandej, duke e trashur theksuar atë buzëqeshje, e përshëndeste tim atë, mandej time më, dhe gjithë duke ndjekur proceduralisht ato gjestet e saj delikate, e linte kutinë mbi sofrën e bukës, e për fund, si pika mbi "i", më përshëndeste edhe mua duke ma hedhur vështrimin mbi syzet e saj bythëkavanoz.

- Nuk do të të dhëmbë! E kam dorën e lehtë, - më thoshte.

Ama dora e saj qe plumb.

E hapte mandej kutinë, gjithë me atë farë rituali tipik prej infermiereje, a thua se kushedi ç'po bënte. Nxirrte prej asaj kutie një nja dy shishka të vogla. Të parën, atë ngjyrë kafe, e kapte me dorën e majtë dhe me gishtin tregues të dorës tjetër i binte nja dy-tre herë, bash siç shtyjmë një pisllëk nga trina e dorës. E merrte lëngun e saj me një shiringë, e pasi e rraste në shihen tjetër me një pluhur të bardhë, i tundte. Lëngu që përftohej nga kjo përzierje ishte bash si dhallë. Këtë dhallë të mirëgatitur e fuste sërish në shiringë, e gjithë duke e përsëritur atë ritualin e rënies me gisht, veçse kësaj here i binte shiringës të merrte drejt meje.

Të gjithë këtë skenë e kundroja i shtrirë në mindere, veçse, jo nga dëshira ime, por nga duart e prindërve të mi që më mbërthenin si morsë, sidomos ato të tim eti. Ndërsa ajo, veshur në të bardha, si fantazmë, avitej drejt meje me atë demonstrimin sikur do të merrte kushedi çfarë haku. Ma prekte me një pambuk të lagur njërën nga mollaqe e të pasmeve, varësisht se cila e kishte radhën dhe mu te pika e zbutur më rraste gjithë atë age. Për fund, sikur donte t'i vinte kapakun ritualit të saj të shenjtë, gjithë duke pëshpëritur se "E kam dorën e lehtë" e shtynte përbërjen, ilaçin në të pasmet e mia.

Me të mbaruar ky ceremonial e falënderoja Zotin për dy gjëra: e para që ky proces nuk zgjaste pafundësisht, dhe e dyta, që nuk ma kishte marrë aftësinë time të çlirimit, të qarën me potere. Ama një herë rituali i saj nuk u plotësua.

E pata vënë re kur po luaja me top në rrugën para portës tek u qas në kthesën e përroit. Dielli ishte fiksuar në atë pikë të qiellit ku luan rolin e një saçi. Për fatin tim të mirë nuk ishte kujtuar ende askush se çfarë po bëja. Ndërsa ajo çka bëja nuk qe kushedi. E gjuaja topin në avllinë e

tim xhaxhai, dhe avllia, si të qe një trajner futbolli, ma kthente saktësisht topin mu te këmba ime. Kjo ishte loja ime e preferuar, e përveç kësaj, ishe loja që e luaja më së shpeshti në çaste e vetmisë sime të madhe, atëherë kur nuk më qaste kush në asnjë lojë. Topthi i diellit në qiell, ia vuri edhe më në dukje mantelin e saj të bardhë te sosi drejtë lagjes sonë. Me ta shquar, e mora topin në dorë, më shumë për të mos ma marrë kush, se për të mos lënë gjurmë. Dhe me të në dorë u futa në oborr, gjithnjë duke mëtuar të gjej një vend të përshtatshëm për t'u fshehur.

Topin e lashë në magazinën pas shtëpisë. Aty i kisha grumbulluar të gjitha lodrat, përzier me veglat që im atë përdorte për të zier rakinë. Pranë veglave të rakisë gjendej një rresht me fuçi të mbushura me bërsi rrushi. U ngjita në njërën prej tyre, e meqë ajo magazinë ishte pa tavan, u ngjita në trarë. Gjithnjë me idenë për të mos u parë nga asnjë tjetër, u dhashë nën çati, bash mu mbi tavanin e odës së burrave, aty ku kisha qëndruar një vit e gjysmë shtrirë. Me tu sistemuar në një tra buzë murit nën kujdesin të mos nxjerr ndonjë farë tingulli dyshues, mbajta vesh.

Si përherë ajo u dha në derë. Thirri tim atë në emër, por doli ime më dhe e mirëserdhi. Por, kur ajo u dha brenda, nuk arrita të dëgjoja kurrfarë gjëje. E vetmja çka munda të rrok, ishte zëri i time ëme kur po e përcillte:

- Në çdo rast do ta sjellim ne. Nuk ka nevojë të vish apet.

Këto dy fjali ma shtinë shapthin. Ja, pra ç'na qenka, - i thashë vetes, - nuk ke shpëtim. - Nëse ti do të zbresësh e jepesh në derë, të dy burrë e grua do të të marrin përdore dhe do të të shpien si çeço tek infermierja.

Që në atë moshë më qe shpifur një lloj mendimi, se disa gjëra që nuk të pëlqejnë, e aq më tepër që i urren,

mund t'i shtysh për më vonë. Ditë e re, nafakë e re, - kisha dëgjuar të thoshin. Kjo qe mënyra si kisha filluar, pak e fije, ta shpëtoja veten. Bash me këtë mendim, thashë të shpëtoj edhe kësaj here. Dil,- i thashë vetes, - merr udhë për diku, e kthehu sa më vonë të jetë e mundur. - Së paku sonte do të shpëtosh. Nesër? Ditë e re, nafakë më e re.

Kështu, zbrita gjithë kujdes nga atje ku isha ngjitur. Dola nga magazina me më shumë kujdes seç isha futur. Dola në rrugë, e përmes fshatit, u nisa për nuk e di ku, gjithë duke ndjekur Rrugën e të Shkuarve.

I kisha bërë që në nëntor gjashtë vjeç, disa gjëra i kisha mësuar, disa rrugë të fshatit i kisha shkelur, disa histori i kisha dëgjuar, disa njerëz të mëhallës sonë i kisha njohur ose më saktë pjesën më të madhe. Me sa duket, kishte ardhur çasti ta njihja edhe më botën përreth.

Në fund të Rrugës së të Shkuarve, shtrihej e lartë dhe kapadaie Kodra e Epërme.

Prej së largu më tërhoqën vëmendjen ca objekte gri e të bardha, si kuti shkrepësesh, që shtriheshin nga rrëza kodrës deri në kubenë e saj. Më bëri përshtypje se si ato qëndronin në atë tërmale. E më së shumti më bëri përshtypje rrethimi i tyre nga një porend akaciesh të mëdha. Ato kishin çelur dhe nga larg të jepnin idenë se në to qe kurdisur vetë parajsa. Kur u afrova, aroma e tyre qe e mahnitshme.

Dy trinat e drurit ishin të hapura sikur të ftonin të futeshe brenda.

Edhe pse nuk kisha filluar ende klasën e parë, dija të lexoja. Më kishte mësuar ime motër, Bela.

Mu në hyrje, kutitë e para të shkrepëseve mbanin mbishkrime me mbiemrin Felaj. Mandej vinin kutitë e shkrepëseve të Ballajve. Anash tyre, gjendeshin ato me

mbiemrin Martinaj. Pak më tej, shtroheshin kutitë e fisit të Gjikajve, e përkarshi tyre, në të njëjtën gjendje, rrinin ato me mbiemrin Sumaj. Këto fise piketonin skajet e formës vezake të kësaj rrethine me akacie. Ndërsa mu në mes tyre, kutizat me mbiemrin Qelaj. Fill në anën veriore të këtij rrethimi, kur rrethi vezak fillonte të ngushtohej, rrinin kutitë e fisit Martinaj të mëhallës së Nënujit, të cilët, në fakt, kur kishin ardhur nga Shkodra në Shterpë e kishin pasur mbiemrin Bejleri, por që në nder të Martinajve të Mbiujit, të cilët iu kishin dhënë bajagi tokë për truall dhe për bukë, ata kishin hequr dorë nga mbiemri i tyre dhe kishin marrë këtë të Martinajve duke u bërë sakaq vllazën në hakikat. Mu pas këtyre, kutitë e fisit të Qoskëve. Ndërsa, në fundin e kësaj rrethine në formë e saj vezake me akacie, bash ku mbaronte ngjitja e Kodrës se Epërme, ku rrinte një bllok tjetër kutizash, lexova mbiemrin tim: Markaj.

Nuk e dija se si qe e mundur e gjitha kjo. Në këtë Kodër jo shumë larg fshatit, na qëndruakan shtrirë tërë këto kutia, që prej larg dukeshin si kutiza shkrepësesh, të cilat kishin të stampuara emra, mbiemra, data lindjeje dhe data vdekjeje, e në të rrallë, mbanin mbishkrime të tjera shtesë, ndonjë strofë poezie, apo ndonjë shpjegim se kush e ka realizuar ndërtimin e asaj kutie.

Lëvizja ashtu nga kutia në kuti duke lexuar emra dhe datat. I lexoja dhe shpesh i lidhja emrat, të cilët i kisha dëgjuar në këto gjashtë vite jetë. Kur po lexoja emrin e një plake, të Markajve, të cilin im atë e kishte përmendur disa herë, më shkuan sytë te një kuti një rresht më tutje. U dhashë gjithë shkujdesje, se a nuk kisha krejt ngenë e botës derisa të errej dhe të qe e pamundur shkuarja në infermieri? Ja, bash me këtë shkujdesje u afrova e tek ajo kuti ngjyrë gri.

Nuk ndryshonte shumë nga të tjerat. Të njëjta përmasa si në gjatësi, ashtu edhe në lartësi. Me sa dukej na ishte një si normë, që ruhej në ndërtimin e këtyre kutizave. Mu në mes të pllakës së sipërme, lulonte një zambak blu, sikur po i bënte karshillëk asaj ngjyre mbizotëruese gri. Përtej zambakëve, dy gjërat që më bënë më së shumti përshtypje ishin: ngjashmëria e gruas në foto me motrat e mia, e sigurisht data e vdekjes, që përkonte me datën time të lindjes.

Kishte edhe një strofë katërvargëshe, të shkruar pjerrët poshtë datave, por në morinë e atyre strofave, që kisha lexuar, nuk e mbajta dot mend.

Ashtu e çova atë pasdite derisa dielli sosi në mes të vargmaleve të Lishit.

Kur u ktheva në shtëpi, të gjithë qenë pataksur nga zhdukja ime. Nuk e merrni me mend poteren qortuese të tim eti, kur më futi me hov brenda. Ama qe veç potere, ngaqë me dorë nuk më preku.

Atë orë para se unë të zhdukesha, - më thanë motrat, - që na kishte ardhur infermierja e fshatit. Nuk ishte lajm për mua, po, vetëm se me një gabim të vogël, ajo kishte ardhur për t'i bërë njërës prej motrave të mia binjake vaksinën e saj të fundit.

Kur ato më lanë në dorë të asaj gruaje me mantelin e bardhë, më kishin pushtuar mendim të tilla. Prisja nga çasti në çast që ajo, nga kushedi çfarë çante të nxirrte një gjilpërë me maje teli dhe me të njëjtin ritual të avitej drejtë të pasmeve të mia. Ja, bashkë me këto imazhe më brente meraku se kush do të më mbante shtrirë teksa ajo do të ma ngulte gjilpërën në mollaqen e radhës.

Kur u gjendëm në një dhomë plot me fëmijë të tjerë, m'u avitën mendime të reja. Nëse ajo do të vinte me çantën

me plus të kuq, dhe do ta niste punën nga rreshti i derës, nuk do të mbaronte gjithë ditën e lume, ama si t'ia bëja po ta niste direkt nga rreshti i dritares ku i pari në radhë isha unë?

Për t'i shpëtuar kësaj torture, ashtu siç qeshë, rroka çantën e dola jashtë. Nëpërmjet rrugës kryesore u dhashë drejt Shterpës.

Në shtëpi nuk më shkohej, gjithë nga frika se ajo virane grua, e në mos ajo, medoemos një grua tjetër, do të jepej mu në pragun tonë, me mantel, sigurisht të bardhë. Kështu u nisa për te vendi që kisha zbuluar në fundin Rrugës së të Shkuarve, aty ku nis Kodra e Epërme.

KY KAPITULL RRËFEHET MË MIRË NGA NJË TREGIM I SHKRUAR DISA VITE MË PARË

Njeriu që ngatërronte emrat e prindërve
(Një krijim i pakrijuar)

I.

Në vogëli kam qenë një topth fund e krye i bardhë, me flokë, vetulla, e shumicën e kohës vishja rroba të bardha. Një topth bore i bardhë që shumë shpejt do të shndërrohej në një lëmsh, një topth me lëndë ndryshe, i përbërë prej fijesh të ngatërruara, por ama pa e humbur aspak bardhësinë.

U njoha me situatën time vetëm në klasë të parë dhe ndodhi pikërisht kështu. Shtatë vjeç i kisha mbushur që në nëntor dhe duhet të isha ndër më të mëdhenjtë e klasës. I ulur në bankën e parë nga rreshti i dritareve, në bankën time ishte ulur, nga ana e murit me dritare, një vajzë që do ta kisha dy vitet pasuese në po atë bankë. Në fakt, dita e parë që isha ndarë nga familja, dhe derisa kisha hyrë në klasë ndoshta edhe kisha qarë. Së paku, kështu më ka thënë ime motër, Bona, gashtë vjet më e madhe, e cila më la te dera e klasës. Jam i bindur që e mbaj mend, por kurrsesi nuk i përjashtoj rrengjet që të ngreh kujtesa. Por, a ka rëndësi kur përjetimet fundja janë të njëjta dhe filli mes ndodhisë dhe imagjinatës është fare i padukë?! Gjithsesi, krejt çka vijon më tej e mbaj mend, në atë shkallë që unë e quaj

cilësi katër K. Fill pesë minuta pasi isha ulur në bankë, dhe kur diç merresha duke shkarravitur mbi të, ia behu në klasë një grua, mosha e sime ëme, e shëndoshë po aq, me flokët po të kapura me një kapëse ngjyrë kafe që i shfaqej në profil, një fustan pak a shumë të ngjashëm, veçse mbi të kishte veshur një bluzë infermiereje, dhe përnjëmend m'u bë sikur jam në një spital. E gjatë ishte pak a shumë sa ime më, madje e pabesueshme, u prezantua me po të njëjti emër: Haxhire.

Pasi u ul, filloi të na pyeste për emrat tanë, emrat e prindërve dhe për emrat e fshatrave nga vinim. Radha po avitej tek unë.

- Po nëna? - më pyeti mua pasi ia thashë emrin tim, atë të babait dhe fshatin nga vija.

- Haxhire, - thash unë.

Më këqyri me njëfarë dyshimi e tek acarimi po i jepej dukshëm nëpër faqe. Më pyeti apet:

- Nuk di as emrin e nënës tënde?

- Haxhire, - i thashë unë sërish, e pas disa grimçastesh shtova:

- Si emri jot (duhet të thosha "juaj").

Dikush qeshi, ndoshta më shumë se dy zëra.

Më pa gjithë habi. Mandej radha degdisi nëpër klasë.

Gjatë atij viti, vetvetiu, duke zënë në ajër tek- tuk ndonjë fjalë, arrita të kuptoja situatën dhe njëkohësisht historinë time. Ime më kishte ndërruar jetë. Më kishte lënë foshnjë disa orësh, dhe që me siguri, edhe pse ma kanë mohuar, lindja ime do të ketë qenë detyrimisht shkaku. Emrin ia mësova pas përfundimit të klasës së dytë kur pata shkuar për pushime verore plot dy javë te dajat, dhe një fqinj i tyre më pati pyetur:

- I Basimes je ti?

II.

Pas 13 vitesh, i vënë para nga rrjedha e pandalshme e jetës, u gjenda në burgun e refugjatëve në Port Smouth të Anglisë. Se si e qysh e tek u gjenda atje, nuk ka rëndësi fort dhe nuk i shërben as edhe një grimë historisë që dua të rrëfej. Fill 15 ditë pasi u gjenda në Port Smouth e pashë veten në një dhomë 3 me 4 në rajonin policor të aeroportit "Nënë Tereza" në Rinas. Ishte një dhomë me copa suvaje që kishin rënë nga tavani dhe muret prej tulle të kuqe. Më pihej ujë, tmerrësisht. Askush nuk pranoi të na sillte as sa për të lagur buzët. Në dhomë ishim mbi 70 vetë, të ngjeshur njëri me tjetrin si peta byreku kthyer vertikal. Ajri i rëndë po na e vështirësonte qëndrimin, e sidomos frymëmarrjen.

Me kalimin e kohës dhoma po boshatisej. Të riatdhesuarit po i merrnin një nga një, ndërkohë që gjunjët e mi nuk e mbanin dot më trupin e tyre. Prej kohësh ishin mpirë, në atë mbrëmje 20 dhjetori të vitit 2013.

- Bekim Markaj! - thirri një burrë me veshje civile, te mbante një letër në dorë, sigurisht që qe listë emrash, ani pse unë tashmë isha i vetmi dhe i fundit.

U ngjita nëpër ca shkallë me dy sheshpushime. Se nga më erdhi ajo fuqi e tillë, një zot e di, pasi këmbët e mia dridheshin si fije bari të thara që era i tund pa teklif, dhe u gjenda në një zyrë.

- Emrin?! - urdhëroi një fytyrë e sertë me uniformë polici, por pa kapelë.

- Bekim.

- Mbiemrin!

- Markaj.

- Vendbanimi!

- Shterpë, Pesëqind.

- Germëzoje të parën! - urdhëroi me një ton disi më të fortë.

- Shter-më, - rrokëzova unë, duke u përqendruar fort te zanoret.

- Emrin e babait!

- Bibë- thash unë.

Fytyra e tij e sertë, më pa me një inat që sikur i kërcente faqeve dhe turrej drejt syve të mi. Mandej çeli gojën me një zë fare të ulët, por i gjithi kërcënues.

- Dëgjo këtu, mos u tall me mua, se të jap një dru të fortë, që ta mbash mend gjithë jetën. Mandej, pasi pushoi disa sekonda, shtoi:

- Babain ta quajnë Beqir, dhe jo Bibë, - tha teksa diç këqyrte në ekranin e kompjuterit.

Heshta. Goja m'u qep si me tel. E dija, kurrë nuk e kisha pasur atë lloj zhdërvjelltësie për t'iu përgjigjur pyetjeve të befta.

- Shkel ligjin, shqiptar dhe atë anglez, e në fund tenton të më rrejsh para syve. E- ja qe krejt hundore dhe e gjatë.

Vërtet u shtanga. Pa kaluar disa grimë çaste, u kujtova që im atë, para dy muajsh e kishte ndërruar emrin, për t'iu shmangur taksave në Greqi ku prej vitesh po punonte.

- Zhduku! - ia pat me të madhe.

Sigurisht që u zhduka edhe pse duhej t'i shpjegoja si qe e vërteta, por ajo piskamë aq e hovshme, dhe sigurisht çoroditja që mbretëronte në mua, nuk më dhanë asnjë dorë.

Nuk u ktheva me në atë dhomë që qelbej erë. Dola jashtë i lirë, por duke u ndjerë gjithë e më çuditshëm, bash si një njeri që ngatërron emrat e prindërve të tij. Sigurisht që nuk e dini si mund të ndjehet një njeri i tillë. Ju kërkoj ndjesë, sepse as unë nuk di s'i ta shpjegoj.

III.

Më duhej të shkoja patjetër në bankë për të hapur një llogari bankare dhe pasi e pata lënë gjithmonë pas dore, e pashë se nuk mbante më ujë pilafi. Dje më në fund e pashë veten në stolat e pritjes në radhë, bashkë me një mikun tim të fakultetit.

Pas sorollatjes dhe shpërfilljes që të bëhet kudo në këto vende, para syve kisha tashmë një grua bullafiqe, e trashë në qafë dhe në trup (mendova se edhe nga mendja e trashë do të qe). Sytë e mi ndiqnin thonjtë e saj të paprerë dhe krahët gjithë pikla të kuqërremta. Kisha parë fytyrë pikaloshe, më së shpeshti fytyrën time në fëmijëri, por pikla në krahë s'kisha parë kurrë.

Duke ia soditur me habi herë thonjtë, herë krahët pikaloshë, më shkëputi zëri i saj i trashë si burrë:

- Urdhëroni zotëri!

- Dua të hap një llogari bankare rrjedhëse! - i thashë më një ton krejt lutës, dhe imagjinova llogarinë të rridhte si një krua, nga ku unë po të doja mund të mbushja një kovë, dy, tre, ose tërë ato kova pambarim.

- Dakord. - Më jepni kartën e identitetit!

- Ja, - ia drejtova fill. E kisha nxjerrë që më parë me idenë se pa atë nuk bëhet kurrfarë gjëje.

- Emrin e babait, të lutem! - më tha, sikur unë të isha një shok saj.

- Bibë, - iu përgjigja shpejt

- Po i nënës?

- Haxhire, - thashë po me ngut

- Okej, - tha dhe iu kthye krakëllimës së tastierës së kompjuterit.

Në çastin pasues u kujtova se të dy emrat e prindërve i

kisha thënë zyrtarisht gabim. Edhe të babait edhe të nënës. Si mundet njeriu ta lëshojë veten në të tilla gabime të trasha?!

Përrotull mendjes m'u avit qetë një shprehje e tim gjyshi, Selë Markajt, që e thoshte sa herë ngelte ndërdyshas përballë një vendimi: "Kam ngelë si Han Kariçi midis dy Drinave". Veçse këtë rast më dukej vetja më i zbrazët në mendje e shpirt se Han Kariçi dhe se të gjithë Hanat së bashku që mund të shkelnin mbi kurrizi të tokës.

Mendova të ndryshoja situatën, dhe ribëja gjendjen kush isha. Si me thënë u mundova ta nxjerr veten nga ai batak shpirtëror dhe ligjor ku isha zhytur. U përvesha sakaq, e sigurisht veç me mend, dhe i thashë:

- Zonjë, më falni!

- Po, - tha ajo pa m'i hedhur sytë, kryengulthi.

- A mundem... ta bëj që tani aplikimin për kartë debiti?

- Sigurisht, - tha ajo. - Menjëherë.

S'më tha asgjë të re, këtë e dija fort mirë. Nuk e pata dot guxim t'i thosha që emrat e prindërve i shënuam gabim. Pasi mbarova u çova krejt përtesë dhe herë më bëhej qejfi që lashë emrat realë, herë më dukej një sikur kisha kryer një akt të pabesë, e herë të tjera më kapte një sëkëlldi se mos më dilte ndonjë problem. Dola jashtë, duke u ndjerë krejt çuditshëm, bash si një njeri që ngatërron emrat e prindërve të tij. Sigurisht që nuk e dini si mund të ndiehet një njeri i tillë. Ju kërkoj ndjesë, sepse as unë nuk di s'i ta shpjegoj.

Sot më erdhi në celular një mesazh: Banka ju uron mirëseardhjen dhe ju falënderon për besimin. Stafi ynë i dedikuar në degë është në shërbimin tuaj!

Prill 2023,
Shterpë, Pesëqind

IKJA E SPEKTATORIT MË TË RËNDËSISHËM

Zërat më vinin të mbytur. Nuk e mbaja mend ekzaktësisht se ku isha dhe çfarë po mendoja. Në fakt, nuk e di përse, por në orët e para të asaj dite, më lodhte shumë të menduarit. Sa herë nisja të mendoja diçka, pra se çfarë do të thotë kjo fjalë apo ajo fjalë, ia plasja të qarës. Tashmë e kisha mësuar këtë taktikë. Nëse diçka të mundon, plasi vajit. Bërtit me sa të mundesh!

Duart e xhaxheshës sime të madhe, teksa me kapin fare pa takt, më kthejnë në realitet.

- Çoja Basimes në prehër, ta mbajë! Të çmallet, - tha xhaxhesha e tim eti.

- Por nuk mundet. Nuk është në gjendje, - tha xhaxhesha e madhe.

- Ani, sa të çmallet pak. Ndoshta edhe djali pushon pak së qarit, - kundërshtoi ajo.

- Paj, për të qarët mos e vrisni mendjen, - ndërhyri xhaxhesha ime e mesit, e mandej shtoi - veç ia hap mushkëritë.

T'u hapshin trutë, tashmë vetë.

- Çoja, çoja, se e di unë këtë punë, - përmbylli xhaxhesha e tim eti.

Dhe pasi më afroi te krevati me çarçafë të bardhë, dhe te më linte në prehrin e sime ëme, ndjeva kur duart e tyre ndërruan në shpinën time. E këqyra për së dyti herë

atë engjëll, nga një perspektivë e mundimshme për mua, ngase, sa herë mundohesha të këqyrja sytë e saj, rrokja në atë perspektivë të mbrapshtë vetëm mjekrën dhe majën e hundës. Të kisha gjuhë për të folur do iu kisha bërtitur:

- Moj gra fyryfyçka, më ngrini disi ndryshe, se dua ta shoh nga sytë, nga fytyra, nuk kam nevojë të shoh mjekrën dhe hundën. Ato nuk më thonë dot asgjë; por ç'e do, gjuha nuk ishte ende mjeti im më i mirë, dhe në pamundësi për të kumtuar nevojat e mia, ia krisa një të qare nga ato që kisha mësuar vetiu.

- Ndoshta i pihet, - tha xhaxhesha e madhe.

- Me siguri, - përforcoi me bindje ajo e mesmja.

- Provoje, Basime, provoje të marrë pak gji, - tha xhaxhesha e madhe.

- Nuk mundet, a nuk e shihni në çfarë gjendje është. Madje ka dy ditë pa shtënë gjë në gojë. - kundërshtoi xhaxhesha e tim eti. Nga ritmi me të cilin fliste dhe nga imponimi që kishte fjala e saj, dukej shumë kompetente në ato që fliste dhe të rejat ia dëgjonin fjalën.

- Por ai fëmijë duhet të pijë, përndryshe s'do e ketë të gjatë, - tha xhaxhesha mesme.

- Goja t'u thaftë! - e mallkoi xhaxhesha e tim eti, dhe pasi mendoi pak, shtoi:

- Sigurisht që do të pijë.

Dhe pasi u kthye kah xhaxhesha ime e vogël me një ton krejt të butë prej fisnikeje tha:- Ti a je ende mëndeshë, apo jo? - Me sa di nuk e ke ndarë ende tët bir nga gjiri. Ai tash i ka mbushur një vit e gjysmë, dhe që sot duhet ta ndash. Nuk do i lëmë kurrë të na ikin të dy. E për çfarë, për një qumësht gjiri?!

E reja e pa drejtë e në kokërdhok të syrit dhe nuk i tha kurrfarë gjëje. E folura e xhaxheshës së tim eti ishte

imponuese. Të tri xhaxheshat e mia kishin ardhur në një shtëpi pa vjehërr, dhe xhaxhesha kishte rolin e saj. Të gjithave ua kishte dhënë këshillat nuseve.. Të gjitha i kishte pritur kur kishin ardhur në derë të shtëpisë. Në dasmat e tyre ajo ishte ulë në konakun e grave dhe i kishte pritur e përcjellë të gjitha gratë e nahijes së Shterpës. E mandej, kur ato nuse kishin ardhur në shtëpinë Markajve, për çdo hall e dert grash ishin përplasur te xhaxhesha e tim eti. Kur kishin shkuar nëpër konakët e grave, për çdo të pame apo qokë, xhaxhesha e tim eti iu kishte hequr para. A mandej, të tria ato, i kishin lindur fëmijët e tyre në prezencën e saj. Ashtu siç duart e xhaxheshës sime të madhe, duart e xhaxheshës së tim eti, kishin tërhequr nga prapaskena trupat e të gjithë kushërinjve dhe kushërirave, përfshirë edhe trupat e dy motrave të mia binjake. Në këtë situatë, ato nuk kishin guxim t'ia bënin fjalën dysh asaj.

Heshtjen e theu sërish ajo, xhaxhesha e tim eti.

- Lime, merrja djalin, - i tha xhaxheshës sime të madhe, e mandej shtoi:

- Ajo duket shumë e këputur. - Djali veç po e rëndon më shumë.

Ndjeva duart e sime ëme të shkëputeshin e të më lëshonin në duar të tjera. Dhe sado që u përpoqa të këqyr edhe njëherë fytyrën e saj, nuk ia dola dot.

- Gra, hajde ta kapim krevatin e djalit. - Ti Lime, mbaje dalin në krahë. Duhet ta shpiem tek oda e burrave. Nuk mbahet djali më këtu. Ajo është rëndë.

Fill ato hapën derën dhe nëpërmjet një salloni të ngushtë kapërcyem nga ana tjetër e shtëpisë. Ja, këtu na pritkan pjesa më e madhe e spektatorëve. Ja ku qenkan ulur të gjithë rresht në minderet në formë U-je. Këtu u prezantova me morinë mashkullore të Markajve; anëtari i

fundit i së cilës isha unë. Të gjithë atë ashpërsi meshkujsh e zbusnin në mënyrë të përkryer dy vajza diku te pesë a gjashtë vjeç, që mu prezantuan pak më vonë si motrat e mia.

Megjithatë, shqisat e mia, e sidomos ajo e të dëgjuarit, kishe raste që edhe funksiononte. Sigurisht që ishte në provat e para, ama diçka kapte dhe atë që kapte nuk e lëshonte dot. Në trurin tim të freskët, ose në nënvetëdijen time taze, e paprekur e si qelibar, zinte vend tek - tuk ndonjë fjali apo pjesë dialogu. Dhe e kam fjalën për këtë si vijon:

- A qite pushkë, or Bibë Marku, se të ka lind djalë, nuk të ka pjellë lopa, tha një plak, koka e të cilit futej në një kësulë të bardhë.

- Ma baj hallall babë, por jam turbullue pak, - tha im atë e me ta sos fjalën kapi pushkën e varur në pamjen ballore të odës dhe doli bashkë me të nga e njëjta derë që më kishin sjellë mua.

Zhurma që kërciti nga jashtë më trembi me tërësej. Dhe sytë e një burri që ishin të ngulur mbi mua thanë në një të qeshur e sipër:

- U tremb prej pushke, or Selë. Qenka tuj na u zbut raca.

- Të gjithë njashtu kemi ndalë që andej, or Pal, por na ka forcue zordja.

Të gjithë ia dhanë një të qeshure disharmonike; asi farë soj nga ku niste njëri nuk soste tjetri.

Kur im atë u dha në derë, me pushkën në dorë me qëllim që ta vendoste aty ku kishte qenë, disa nga burrat u çuan në këmbë dhe u prirën drejtë meje.

- Ta kesh me jetë, o Selë Marku dhe t'u bëftë katund, - ia dha një nga ata burrat e odës dhe sakaq një kartëmonedhë u dha në kafazin e krevatit tim.

- E pastë faqen e bardhë! - ia dha një tjetër.

- U shtofshin sa më shumë djemtë e Markajve, - ia pat dikush tjetër.

E kështu me radhë të gjithë burrat e asaj dhome uruan secili në një formë të veçantë, pa përsëritur asnjë fjalë të njëri- tjetrit. Ndërkohë, kartëmonedhat mbini në rend njëra pas tjetrës si gjethet e një peme në një fillim të tetorit.

Dy fytyra të njoma afrohen drejtë kafazit të krevatit tim. M'u dukën sikur ishin shëmbëllime të njëra- tjetrës. Që të dyja i kishin flokët kaçurrela. Që të dyja i kishin sytë kafe. Që të dyja i kishin fytyra disi në mavi. Duke i parë me vëmendje kuptova se që të dyja ishin shëmbëllim i mamasë.

- Unë jam motra jote, - tha zëri njërës prej tyre.

- Edhe unë jam motra jote, - përsëriti tjerat fill dhe zëri i tyre më u bë kur ishte thjesht përsëritje.

- Mirë se erdhe Bebi! - ia pritën të dyja në kor.

- Yyy sa të vogla i ka duart, - tha njëra.

Nuk e dija se cila prej tyre thoshte çfarë, por për mua pak rëndësi kishte, ngase që të dyja ishin motrat e mia identike. Nuk i kisha njohur ende mjaftueshëm për t'i dalluar në personalitet. Pa ditur se si, ndjeja që prezenca e këtyre dy spektatoreve të veçanta, më bënte të ndjehesha disi më mirë.

- Picirruk, - tha tjetra.

- Si kukullat tona që na i solli babi për ditëlindje, - vazhdoi e para.

Ia, i thashë vetes, për kësi bisedash dhe për kësi spektatorësh ke nevojë derisa të fillosh e të familjarizohesh me skenën.

- O ba! - e thërret njëra prej tyre, ngaqë, ndjesë, ende nuk jam në gjendje të dalloj se kush është cila, - si e ka emrin bebi?